



DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Bazuar në nenin 62.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Rregulloren MF-Nr.04/2017 mbi kriteret standarte dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nenin 61 paragrafi 1 dhe 2 të statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet, programeve të organizatave joqeveritare në Komunën e Podujevës nr. Protokollit 02-400/03-0013409/25, datë 04.03.2025,

THIRRJE PUBLIKE

për mbështetje financiare publike për projekt/programet e OJQ-ve

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën së Podujevës u bënë thirrje publike të gjitha organizatave joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në Komunën e Podujevës, të **APLIKOJNË** për mbështetje financiare publike të projekteve/programeve që kontribuojnë në zbatimin e programit të DSHMS-së, i cili u dedikohet personave me nevoja të veçanta.

OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë në fushat si në vijim:

- Fushata avokuese dhe lobuese për avancimin e pozitës së personave me nevoja të veçanta në shoqëri;
- Ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes dhe këshillimeve psiko-sociale për personat me nevoja të veçanta;
- Programe/projekte për përkujdesje dhe trajtim të personave me nevoja të veçanta;
- Aktivitetet lidhur me shërbimet e rehabilitimit, socializimit të personave me nevoja të veçanta si dhe fushat të tjera të ngjashme.
- Ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes, përkrahjes dhe këshillimeve psiko-sociale për fëmijët pa përkujdesje prindërore;
- Zhvillimin dhe fuqizimin e strehimit familjar si formë alternative e mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdesje prindërore;
- Mbështetje psiko-sociale në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në nevojë;
- Fushata avokuese dhe sensibilizuese për trajnimet e familjeve potenciale strehuese.

Kërkesës duhet bashkëngjitur dokumentet:

1. **Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së dhe certifikatën e numrit fiskal;**
2. **Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së;**
3. **Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së;**
4. **CV-ja e menaxherit të projektit;**
5. **Dëshminë e implementimit të projekt/programeve të ngjashme;**
6. **Dëshminë se OJQ-ja aplikuese nuk është në procedurë të shuarjes dhe çregjistrimit;**
7. **Formulari i propozim buxhetit të projektit/programit** <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2025/03/F-10-Formulari-i-propozim-buxhetit-te-projektit.docx>
8. **Formë e deklaratës për mungesën e financimit të dyfishtë;** <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2025/03/F-11-Forme-e-deklarates-per-mungesen-e-financimit-te-dyfishte.docx>
9. **Formë e deklaratës së partneritetit(nëse është e aplikueshme);** <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2025/03/F-12-Forme-e-deklarates-se-partneritetit.doc>
10. **Forma e deklarimit të programeve /projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike;** <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2025/03/F-13-Forma-e-deklarimit-te-programeve-projekteve-te-OJQ-ve-te-financuara-nga-burimet-publike.docx>
11. **Formë e deklaratës mbi aktivitetet e përshkruara të programit/projektit;** <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2025/03/F-14-Forme-e-deklarates-mbi-aktivitetet-e-pershkruara-te-programit-projektit.docx>
12. **Formë e një raporti përshkrues të programit/projektit;** <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2025/03/F-17-Forme-e-nje-raporti-pershkrues-te-programit-projektit.doc>
13. **Formë e pasqyrave financiare të programit /projektit;** <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2025/03/F-18-Forme-e-pasqyrave-financiare-te-programit-projektit.docx>
14. **Vërtetimin mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore i cili duhet të dorëzohet komisionit vlerësues para publikimit të rezultateve përfundimtare;**
15. **Formulari për shëndetësi ;**<https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2025/03/Formulari-F-15-per-shendetesi-1.docx>
16. **Forma e aplikacionit;**<https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2025/03/F-9-Aplikacioni-per-projekt-program.docx>
17. **Udhëzuesi për aplikantët-** <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2023/03/Udhezimet-per-aplikantet-2025.doc>

-Vlera totale financiare e planifikuar e thirrjes publike është **20,000 €**

-Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një projekt individual është **500 €**.

-Shuma maksimale për një projekt është **15,000 €**.

- OJQ-të mund të aplikojnë vetëm me një (1) projekt.
- Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe fillon nga data **05.03.2025** dhe përfundon më **25.03.2025**.
- Periudha e zbatimit të projektit është deri më **31.12.2025**.

Kriteret për pjesëmarrje në thirrjen publike:

- OJQ-të, të cilat janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në Komunën e Podujevës, së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike.
- OJQ-të , duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e avancimit të personave me nevoja të veçanta dhe të kenë të parapara me statutet e tyre si dhe ne mbrojtjen , perkrahjen dhe formen alternative te mbrojtjes se femijeve te cenuar.
- OJQ-të, të cilat nuk kanë të përmbyllur raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Podujevës në këtë thirrje.
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete.
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve / udhëheqësit të aplikuesit dhe institucionit publik siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara nëse është e aplikueshme.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë të cilat së bashku me Udhëzimet për aplikantë janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>

- Dokumentet e kompletuara dërgohen në adresën e mëposhtme:
Qendra për Shërbim të Qytetarëve, kati i parë në ndërtesën e Komunës së Podujevës, rr. "Nuhi Gashi", **në zarfe të mbyllura**.
- Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
- Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
- Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: dshms.podujeva@rks-gov.net

Format e raportimit:

Formë e një raporti përshkrues të programit/projektit; (Formulari F 17)

Formë e pasqyrave financiare të programit /projektit; (Formulari F 18)

Bashkëngjitur gjeni udhëzimet e thirrje publike së bashku me formularët.

Nr. prot: 06-400/04-0013773/25
Podujevë, datë: 03 mars 2025

Drejtoresha
Adelina Stublla



